



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 42

Tiranë – E enjte, 28 mars 2019

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 16/2019 datë 13.3.2019	Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr. 9965, datë 24.7.2008..... 3507
Ligj nr. 17/2019 datë 13.3.2019	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin Universitar të Tiranës, sipas parimit të efikasitetit energjetike, faza IIP”..... 3508
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.158, datë 27.3.2019	Për lirin dhe emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave..... 3510
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 159, datë 27.3.2019	Për lirin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Shkodrës..... 3510
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.160, datë 27.3.2019	Për lirin dhe emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve..... 3510
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 161, datë 27.3.2019	Për lirim nga detyra..... 3511
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.162, datë 27.3.2019	Për largimin nga detyra të një anëtarit të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura..... 3511
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 163, datë 27.3.2019	Për emërim në detyrë..... 3511
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 167, datë 27.3.2019	Për indeksimin e pensioneve..... 3511

Vendim i Këshillit të Ministrave  
nr. 168, datë 27.3.2019

Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” .....



**LIGJ**  
**Nr. 16/2019**

**PËR RATIFIKIMIN E  
LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE  
TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE SHOQATËS  
NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM  
(IDA) PËR PROJEKTIN “SIGURIA E  
DIGAVE”, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN  
NR. 9965, DATË 24.7.2008**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet letërmarrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr. 9965, datë 24.7.2008, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.3.2019

**Shpallur me dekretin nr. 11150, datë 25.3.2019  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Ilir Meta**

BANKA BOTËRORE

IBRD-IDA/GRUPI  
BANKA BOTËRORE

LINDA VAN GELDER  
Drejtori Rajonal, Ballkani  
Perëndimor  
Rajoni i Evropës dhe Azisë  
Qendrore

SH. SË TIJ, Arben Ahmetaj  
Ministër  
Ministria e Financave dhe  
Ekonomisë  
SHQIPËRI

ZYRA E GRUPIT TË  
BANKËS BOTËRORE

Praterstrasse 31/21  
Vienna, Austria, 1020

15 qershor, 2018

**I nderuar z. Ministër,**

*Shqipëria: Komuniteti i Energjisë së Programit të Evropës Juglindore - Projekti i Sigurisë së Digave (Huaja nr. 4480 - ALB)*  
*(Ripërcaktimi dhe shtyrja e datës së mbylljes)*

Ne i referohemi: a) Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Marrësi”) dhe Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit (“Shoqata”) (“Marrëveshja e Financimit”); dhe b) Marrëveshja e Projektit ndërmjet Shoqatës dhe Korporatës Energjetike Shqiptare (“KESH”) (“Marrëveshja e Projektit”), të dyja të datës 2 korrik 2018 dhe të ndryshuara që sot për Projektin e lartpërmendur.

Marrëveshja Financiare është modifikuar si më poshtë:

1. Plani 2, seksioni IV. A2 (Tërheqja e shumës së financimit).

Tabela sipas këtij seksioni është modifikuar për të rialokuar shumat brenda kategorive ekzistuese siç pasqyrohet në shtojcën e kësaj shkrese.

2. Seksioni IV.B.2: Data e mbylljes është shtyrë deri më 31 dhjetor 2020.

I juaji shumë sinqerisht,

**BANKA NDËRKOMBËTARE PËR  
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Linda Van Gelder  
Drejtori Rajonal, Ballkani Perëndimor  
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

Tel.: +43 (1) 2170 782

Faks: +43 (1) 2170 701

SH. SË TIJ, Arben Ahmetaj

15 qershor, 2018



SHTOJCA  
TËRHEQJA E SHUMËS SË KREDISË

Kategoria	Shuma e kredisë së përcaktuar (shprehur në SDR)	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen
1. Mallrat dhe punimet	14,550,000	100%
2. Shërbimet e konsulentëve dhe trajnime përveç pjesëve 2.1 dhe 2.4 të Projektit	5,000,000	100%
3. Shërbimet e konsulentëve të zhvillimit të hidrocentraleve dhe menaxhimit të ujit për pjesët 2.1 dhe 2.4 të Projektit	2,150,000	100%
<b>SHUMA TOTALE</b>	<b>21,700,000</b>	

Tel.: +43 (1) 2170 782

Faks: +43 (1) 2170 701

**LIGJ**  
**Nr. 17/2019**

**PËR RATIFIKIMIN E  
MARRËVESHJES NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE  
TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM  
FINANCIAR 2017, PËR PROJEKTIN  
“PROGRAMI PËR RINOVIMIN E  
KONVIKTEVE NË KAMPUSIN  
UNIVERSITAR TË TIRANËS, SIPAS  
PARIMIT TË EFICIENCËS  
ENERGJETIKE, FAZA III”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike, faza III”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.3.2019

**Shpallur me dekretin nr. 11151, datë 25.3.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta**

**MARRËVESHJE**  
NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS  
FEDERALE TË GJERMANISË  
PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR  
2017  
PËR PROJEKTIN “PROGRAMI PËR  
RINOVIMIN E KONVIKTEVE NË  
KAMPUSIN UNIVERSITAR TË TIRANËS  
SIPAS PARIMIT TË EFICIENCËS  
ENERGJETIKE, FAZA III”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe për t'i thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë, të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,



me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke iu referuar premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë datë 9 nëntor 2017 (nota verbale nr. 283/2017)

kanë rënë dakord si vijon:

#### Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) shumën e financimit në vlerë të përgjithshme deri në 2 927 765,96 euro (me fjalë: dy milionë e nëntëqindnjëzeteshtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro, e nëntëdhjetë e gjashtë cent), për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës sipas parimit të eficiencës energjetike, faza III, nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur dhe konfirmohet, se i plotëson kriteret e veçanta të financimit në formën e një shume financimi si një masë për përmirësimin e pozicionit të gruas në shoqëri, si masë e orientuar për nga vetë ndihma në luftën kundër varfërisë, si fond i garancisë së kredive apo projekt në sektorin e infrastrukturës sociale ose mbrojtjes së mjedisit.

2. Projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse për këtë bien dakord Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, përkatësisht për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

#### Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së

porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të shumës së financimit, të cilat nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, do të zhvlerësohet, në rast se kontratat përkatëse të financimit nuk lidhen deri në fund të datës 31 dhjetor 2018.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e detyrimeve, që mund të lindin në bazë të kontratave të financimit, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

#### Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1. Tatimi mbi vlerën e shtuar, si dhe taksa e tatime të ngjashme indirekte, që lindin në këtë kontekst, mbarten nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Taksa të tjera të veçanta konsumi merren përsipër nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Krahas kësaj, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike.

#### Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr sipas rastit lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.



## Neni 5

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Regjistrimi i kësaj marrëveshjeje pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara realizohet menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pala tjetër kontraktuese njoftohet rreth regjistrimit të kryer përmes përcjelljes së numrit të regjistrimit të Kombeve të Bashkuara, sapo ky numër të jetë konfirmuar prej Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

3. Kjo Marrëveshje lidhet për një afat të pacaktuar. Secila prej palëve në marrëveshje mund ta zgjidhë atë në çdo kohë me shkrim në rrugë diplomatike; zgjidhja e marrëveshjes bëhet e vlefshme 30 ditë pas mbërritjes së këtij njoftimi pranë palës tjetër kontraktuese.

4. Palët kontraktuese mund të bien dakord për ndryshime të marrëveshjes.

5. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo me zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në dakordësi mes palëve kontraktuese përmes bisedave apo bisedimeve përkatëse.

Bërë në Tiranë, më \_\_\_\_\_, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë  
Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë

**VENDIM****Nr. 158, datë 27.3.2019**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË  
DETYRË TË DREJTORIT TË  
PËRGJITHSHËM TË DOGANAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Znj. Belinda Ikonomi, drejtor i Përgjithshëm i Doganave, lirohet nga kjo detyrë.

Faqe | 3510

2. Z. Arlind Gjokuta emërohet drejtor i Përgjithshëm i Doganave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 159, datë 27.3.2019**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË  
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT  
TË SHKODRËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Z. Çesk Millja, prefekt i qarkut të Shkodrës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Valdrin Pjetri emërohet prefekt i qarkut të Shkodrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 160, datë 27.3.2019**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË  
DETYRË TË DREJTORIT TË  
PËRGJITHSHËM TË TATIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Znj. Vasilika Vjero, drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Enton Duro emërohet drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 161, datë 27.3.2019****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Znj. Albana Shkurta, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 162, datë 27.3.2019**

**PËR LARGIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 5, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Z. Rudolf Papa, anëtar i Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, largohet nga kjo detyrë për shkak të dorëheqjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 163, datë 27.3.2019****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Znj. Belinda Ikonomi emërohet zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 167, datë 27.3.2019****PËR INDEKSIMIN E PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 61 e 88, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, të nenit 24, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në



miniera në nëntokë”, të nenit 6/1, të ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të nenit 1, të ligjit nr. 8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetëseve dhe palombarëve të forcave detare në pension”, të nenit 8, të ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

#### VENDOSI:

1. Indeksimin, në masën 2.8 për qind:

a) të pensioneve të caktuara sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) të pensioneve sociale, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) të shtesës mujore, të përfituar me vendimin nr. 326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;

ç) të pensioneve të caktuara me dekretin nr. 758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”;

d) të shtesës mbi pension, të dhënë sipas nenit 33, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

dh) të shtesave mbi pension, të dhëna sipas neneve 38, 39 dhe 48, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 24, të ligjit nr. 4171, datë 13.6.1966, “Për sigurimet

shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

e) të pensioneve të caktuara dhe të rillogaritura me ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21, të këtij ligji;

ë) të trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara sipas ligjeve nr. 8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, dhe nr. 9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar;

f) të trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetëseve dhe palombarëve të forcave detare në pension”;

g) të trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve të minierave, të caktuara sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar,

gj) të pensioneve të pleqërisë të punonjësve të minierave, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

h) të trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”;

i) të pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”;

j) të pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë





funksiione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;

k) tëshpërblimit të caktuar sipas ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të ndryshuar;

l) të pensioneëve shtetërore të posaçme të caktuara në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Indeksimin, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.4.2019 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.3.2019, përfshirë edhe këtë datë.

3. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneëve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të këtij ligji, si dhe pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, që kanë datë fillimi të të drejtës deri më 31.12.2014, pas datës 1.4.2019 nuk do të jenë më pak se 13 753 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj dhe më shumë se 27 506 (njëzet e shtatë mijë e pesëqind e gjashtë) lekë në muaj.

4. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.12.2014, pas datës 1.4.2019 nuk do të jenë më pak se 9 418 (nëntë mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë) lekë në muaj, por jo më shumë se 13 753 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj.

5. Pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.4.2019 e në vazhdim, nuk do të jenë më pak se 13 753 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj.

6. Përfituesit e pensioneëve, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në

Republikën Popullore të Shqipërisë”, nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, si dhe nr. 150/2014, të caktuara pas datës 1.7.2018, por me datë të fillimit të pensionit deri më 31.12.2014, përfshi edhe këtë datë, përveç pensionit, do të përfitojnë edhe kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneëve”, nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneëve”, nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneëve”, dhe nr. 17, datë 20.1.2007, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”, me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave, pas indeksimit të pensioneëve sipas pikës 1, të këtij vendimi, të jetë:

a) deri në 15 403 (pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e tre) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, përfshirë edhe përfituesit e pensioneëve sipas ligjit nr. 150/2014;

b) deri në 14 903 (katërmëdhjetë mijë e nëntëqind e tre) lekë në muaj, për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare;

c) deri në 10 108 (dhjetë mijë e njëqind e tetë) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

7. Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneëve”, nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneëve”, dhe nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneëve”, do t'i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione të parakohshme, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, me datë fillimi nga 1.4.2019 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 15 403 (pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e tre) lekë në muaj.



8. Përfituesit e pensioneve, sipas shkronjave “a”, “e”, “gj”, të pikës 1, të këtij vendimi, me datë fillimi të pensionit deri në 31.12.2014 dhe përfituesit e pensioneve të parakohshme sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, krahas pensionit dhe kompensimeve, sipas përcaktimeve në pikat 6 dhe 7, të këtij vendimi, do të marrin edhe kompensimet sipas masës dhe kritereve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, dhe nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”.

9. Shuma bazë e pensionit e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke filluar nga data 1.4.2019 e në vazhdim të jetë 7 465 (shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë.

10. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përlllogariten në shumën 2 390 000 000 (dy miliardë e treqind e nëntëdhjetë milionë) lekë, dhe përballohen nga fondi për politikën e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e ISSH-së të vitit 2019, të cilat ndahen:

a) 2 376 000 000 (dy miliardë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë) lekë, për mbulimin e pagesave të përfitimeve;

b) 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare, sh.a.

11. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimit teknik të zbatimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.4.2019.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

## VENDIM

Nr. 168, datë 27.3.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 132, DATË 7.3.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR METODOLOGJINË PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME TË PASURISË SË PALUAJTSHME “NDËRTEA”, E BAZËS SË TAKSËS PËR KATEGORI SPECIFIKE, NATYRËN DHE PRIORITETIN E INFORMACIONIT DHE TË DHËNAVE PËR PËRCAKTIMIN E BAZËS SË TAKSËS, SI DHE TË KRITEREVE DHE RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN ALTERNATIV TË DETYRIMIT TË TAKSËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, 22/1, 22/3 e 22/4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Aneksi 1 zëvendësohet, përkatësisht, me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Aneksi 2 zëvendësohet, përkatësisht, me aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

## ANEKSI 1

**ÇMIMET MESATARE REFERUESE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR VLERËSIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME PËR BANESAT**

Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së:

a) ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, sipas qyteteve, për çdo bashki, sipas qarqeve.

a.1) Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, sipas qyteteve, për çdo bashki, sipas qarqeve (me përjashtim të Bashkisë Tiranë):



Nr. r. qarkut	Qarku	Nr. r. bashki	Bashkia	Nr. r. qytete	Nr. r. qytet i qarkut	Qytetet	Lekë/m <sup>2</sup> sipërfaqe shfrytëzimi
1	Berat	1	Berat	1	1	Berat	41 400,00 lekë
		2	Poliçan	2	2	Poliçan	26 000,00 lekë
		3	Ura Vajgurore	3	3	Ura Vajgurore	37 000,00 lekë
		4	Kuçovë	4	4	Kuçovë	36 000,00 lekë
		5	Skrapar	5	5	Çorovodë	25 000,00 lekë
2	Dibër	6	Dibër	6	1	Peshkopi	49 000,00 lekë
		7	Mat	7	2	Burrel	44 300,00 lekë
		8	Klos	8	3	Klos	32 000,00 lekë
		9	Bulqizë	9	4	Bulqizë	41 800,00 lekë
3	Durrës	10	Durrës	10	1	Durrës	67 500,00 lekë
		11	Shijak	11	2	Shijak	41 000,00 lekë
		12	Krujë	12	3	Krujë	48 500,00 lekë
13	4			Fushë Krujë	51 000,00 lekë		
4	Elbasan	13	Elbasan	14	1	Elbasan	50 300,00 lekë
		14	Belsh	15	2	Belsh	35 000,00 lekë
		15	Cërrik	16	3	Cërrik	38 300,00 lekë
		16	Peqin	17	4	Peqin	39 000,00 lekë
		17	Librazhd	18	5	Librazhd	44 000,00 lekë
		18	Përrenjas	19	6	Përrenjas	41 780,00 lekë
		19	Gramsh	20	7	Gramsh	43 000,00 lekë
5	Fieri	20	Fier	21	1	Fier	53 100,00 lekë
		21	Patos	22	2	Patos	28 000,00 lekë
		22	Roskovec	23	3	Roskovec	30 000,00 lekë
		23	Lushnjë	24	4	Lushnjë	40 100,00 lekë
		24	Divjakë	25	5	Divjakë	40 100,00 lekë
		25	Mallakastër	26	6	Ballsh	30 000,00 lekë
6	Gjirokastrë	26	Gjirokastrë	27	1	Gjirokastrë	47 400,00 lekë
		27	Dropull	28	2	Sofratikë	27 000,00 lekë
		28	Libohovë	29	3	Libohovë	27 000,00 lekë
		29	Përmet	30	4	Përmet	37 000,00 lekë
		30	Këlcyrë	31	5	Këlcyrë	24 600,00 lekë
		31	Tepelenë	32	6	Tepelenë	32 500,00 lekë
		32	Memaliaj	33	7	Memaliaj	15 000,00 lekë
7	Korçë	33	Korçë	34	1	Korçë	45 800,00 lekë
		34	Maliq	35	2	Maliq	27 800,00 lekë
		35	Pustec	36	3	Pustec	35 000,00 lekë
		36	Devoll	37	4	Bilisht	35 000,00 lekë
		37	Pogradec	38	5	Pogradec	49 900,00 lekë
		38	Kolonjë	39	6	Ersekë	23 000,00 lekë
40	7			Leskovik	21 000,00 lekë		
8	Kukës	39	Has	41	1	Krumë	24 500,00 lekë
		40	Kukës	42	2	Kukës	54 000,00 lekë
		41	Tropojë	43	3	Bajram Curri	27 900,00 lekë
9	Lezhë	42	Lezhë	44	1	Lezhë	56 000,00 lekë
				45	2	Shëngjin	56 000,00 lekë
		43	Kurbin	46	3	Laç	42 500,00 lekë
				47	4	Milot	34 000,00 lekë
		44	Mirditë	48	5	Rrëshen	42 000,00 lekë



				49	6	Rubik	29 500,00 lekë
10	Shkodër	45	Shkodër	50	1	Shkodër	58 000,00 lekë
		46	Vau i Dejës	51	2	Vau i Dejës	24 300,00 lekë
		47	Malësi e Madhe	52	3	Koplik	40 500,00 lekë
		48	Pukë	53	4	Pukë	22 000,00 lekë
		49	Fushë Arës	54	5	Fushë Arës	7 500,00 lekë
11	Tiranë	50	Kavajë	55	1	Kavajë	51 000,00 lekë
		51	Rrogozhinë	56	2	Rrogozhinë	41 000,00 lekë
		52	Vorë	57	3	Vorë	51 500,00 lekë
		53	Kamzë	58	4	Kamzë	52 000,00 lekë
12	Vlorë	54	Sarandë	59	1	Sarandë	56 000,00 lekë
		55	Konispol	60	2	Konispol	28 000,00 lekë
		56	Finiq	61	3	Livadhja	28 000,00 lekë
		57	Vlorë	62	4	Vlorë	61 800,00 lekë
				63	5	Orikum	60 000,00 lekë
		58	Himarë	64	6	Himarë	58 000,00 lekë
		59	Selenicë	66	7	Selenicë	25 000,00 lekë
60	Delvinë	67	8	Delvinë	26 750,00 lekë		

a.2) Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi për Bashkinë Tiranë:

Bashkia Tiranë	Nr. i njësisë administrative	Nr. rendor	Zona	Lekë/m <sup>2</sup> sipërfaqe shfrytëzimi
Qyteti Tiranë sipas ndarjeve zonale për çdo njësi administrative	1	1	1/1	97 700,00 lekë
		2	1/2	78 000,00 lekë
	2	3	2/1	187 000,00 lekë
		4	2/2	134 500,00 lekë
		5	2/3	95 000,00 lekë
		6	2/4	110 000,00 lekë
		7	2/5	80 000,00 lekë
	3	8	3/1	77 000,00 lekë
		9	3/2	60 000,00 lekë
	4	10	4/1	70 000,00 lekë
		11	4/2	60 000,00 lekë
	5	12	5/1	190 000,00 lekë
		13	5/2	132 000,00 lekë
		14	5/3	107 000,00 lekë
		15	5/4	82 000,00 lekë
	6	16	6	65 000,00 lekë
	7	17	7/1	120 000,00 lekë
		18	7/2	100 000,00 lekë
		19	7/3	85 000,00 lekë
		20	7/4	65 000,00 lekë
	8	21	8/1	110 000,00 lekë
		22	8/2	100 000,00 lekë
		23	8/3	72 000,00 lekë
	9	24	9/1	130 000,00 lekë
		25	9/2	100 000,00 lekë
		26	9/3	77 000,00 lekë



	10	27	10/1	145 000,00 lekë
		28	10/2	139 500,00 lekë
		29	10/3	102 000,00 lekë
	11	30	11/1	87 000,00 lekë
		31	11/2	75 000,00 lekë
		32	11/3	70 000,00 lekë
<b>Njësitë administrative Bashkia Tiranë</b>	12	33	Baldushk	32 000,00 lekë
	13	34	Bërzhitë	34 000,00 lekë
	14	35	Dajt	53 500,00 lekë
	15	36	Farkë	66 500,00 lekë
	16	37	Kashar	53 500,00 lekë
	17	38	Kërrabë	28 200,00 lekë
	18	39	Ndroq	34 000,00 lekë
	19	40	Petrelë	53 500,00 lekë
	20	41	Pezë	53 500,00 lekë
	21	42	Shëngjergj	23 000,00 lekë
	22	43	Vaqarr	34 000,00 lekë
	23	44	Zall-Bastar	25 000,00 lekë
24	45	Zall-Herr	28 200,00 lekë	

b) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuar për banim në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësitë të vetëqeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësitë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, reduktohet deri në 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë, ky reduktim është deri në 30 (tridhjetë) për qind krahasuar me çmimin e zonës më të afërt.

c) Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë.

## ANEKSI 2

### ÇMIMET MESATARE REFERUESE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR VLERËSIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME PËR NDËRTIME DHE AMBIENTE JO-BANIMI

a) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë

kategori përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë ky koeficient është 2 (dy) herë më i lartë.

b) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

c) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

ç) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuar për veprimtari industriale, të tilla si prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme me to është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse sipas qyteteve.

d) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.





	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë